



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 66 prot.

Kamëz, më 18.04.2023

V E N D I M

Nr. 52, datë 18 . 04 ,2023

MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË NË VAZHDIM", PËR VITIN 2023 ME FONDE NGA BUXHETI SHËTETIT.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.04.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.31, Datë 14.04.2023, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", vendimit nr.47, datë 19.04.2022, të Këshillit Bashkiak "Mbi disa ndryshime në VKB nr. 66 Datë 25.06.2020 Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencionimi i interesave të Kredisë" i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak "Për ngritjen e Komisionit të Strehimit"; të Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, Vendimit nr. 453, datë 3.7.2019 të Këshillit të Ministrave "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti"; shkresës me nr. Prot.13 dt. 04.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.3347 Prot datë 18.04.2023, Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.3347/1 Prot datë 18.04.2023, Këshilli Bashkiak Kamëz;

V E N D O S I :

1. Listën e familjeve për të përfutuar nga programi Strehimit Social "*Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim*", për vitin 2023, sipas Aneksit nr. 1, dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1 të këtij vendimi, duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve pranë institucionit bankar, nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz. Mosrespektimi i këtij afati është shkak për s'kualifikimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

